REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 895/20
Datë/Datum. 02.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.895/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Nuhi Paçarizi - Kryetar, Panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.SH "SPINP AGENCY"- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "LOGISTICS PLUS"L.L.C -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e STN-se", me numër të prokurimit: 204-20-5872-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, më datën: 01.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuara ankesat e operatorëve ekonomik N.SH "SPINP AGENCY"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e STN-se", me numër të prokurimit: 204-20-5872-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e STN-se", me numër të prokurimit: 204-20-5872-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.SH "SPINP AGENCY"- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.SH "SPINP AGENCY"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 06.11.2020 me nr. 895/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e STN-se", me numër të prokurimit: 204-20-5872-2-3-6 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 56, 59 dhe 72 te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 39 te RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr. 895/20 është arsyeja e eliminimit të OE ankues, ku sipas arsyetimit të AK-së OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën :

"Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 person si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit."

Ndër të tjera në arsyetimi i AK-së për eliminim është thotë :"...ju në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar përmes platformës së E-Prokurimit nuk keni ofruar inxhinierin e shkencave kompjuterike për përvojë 3 vjeçare pasi inxhinierin e ofruar është diplomuar me date 22.11.2018, ne këtë rast inxhinier nuk munde te quhet pa diplomë dhe përvoja e punës është kërkuar 3 vite ne fushë veprimit te profesionit te inxhinierit ndërsa për sqarime shtese nuk ka pasur nevoje pasi ne listën e stafit te ofruar keni ofruar vetëm personi/inxhinieri i cili ka diplomuar me 22.11.2018 qe nuk plotëson kërkesat ligjore sipas LPP dhe UOPP..."

Fillimisht sqarojmë në kërkesa të AK-së nuk është kërkuar Inxhinier, e po ashtu çka është me rëndësi në rastin konkret nuk është kërkuar shprehimisht që përvoja 3 vjeçare duhet të jetë pas diplomimit universitar, kërkesa decidive ka qenë:

"...diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit".

Nga CV e ofruar prej OE ankues, shihet se personi në fjalë ka përvojë si "Softëare Developer" që nga viti 2014.

CV

Drin Percuku
Vushtrri
Republika e Kosovës

+383 49 490 100
Drin.percuku@spinpagency.com

EXPERIENCE

Spinp Agency
2019 - Present

Backend Developer

- Responsible for the architeture, development and implementation of a ëide variety of Ëeb-based products.
- Responsible for developing costumized CMS (CMS Canvas) using PHP, JavaScript, relational databases, broxvser Extensions.
- Responsible for training the staff and clients in using the products (like: CMS, Databases, E-commerce, Email modules,etc.)
- Developing strategies to implement solutions
- Identifying resources and using them efficiently
- Analyzing IT needs vvithin organizations and designing business strategies
- Conducting research and market analysis
- Giving objective advice on the use and benefits of IT

Dina Tech
08/2017 -09/2019
Softëare Developer

- Supervise preparation and regular updating of class schedules and changes
- Responsible for the development and implementation of Ëeb-based products using PHP, JavaScript, relational databases, brovvser Extensions.
- Perform marketing strategies to promote classes and programs
- Prepare detailed financial reports totaling thousands of dollars
- Integration of academic planning and class scheduling

Illv Soft
2014-2017
Softëare Developer - Backend Developer

- Developing Ëeb-based products using PHP. JavaScript, MySql, Codeigniter, Laravel, brovvser Extensions. etc.

Freelancer Softëare Developer
2013- on going
Full Stack Developer
Developing and maintaining different kind of ëeb projects, using mainly PHP, MySQL, Javasript, as a freelancer/indepedently.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se OE ankues ka dorëzuar ofruar dëshmitë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues, me datë: 23.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar,

Si Autoritet Kontraktues kemi shqyrtuar ekspertizën e ekspertit shqyrtues ne pretendimet e Operatorit Ekonomik: NSH SPINP AGENCY.; "duke analizuar me kujdes përgjigjet/konstatimet e ekspertit dhe si rrjedhojë japim komentin dhe kundërshtimet tonë në raportin e ekspertit.

Konstatimi i ekspertit

Sipas mendimit të ekspertit konstatime të cekura në raportin e ekspertizës, AK – MTI nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe ka japë mendim qe te anuloj vendimin e AK-së, për dhënie te kontratës dhe rekomandon qe lënda te kthehet ne rivlerësim, ankesa OE ankues Operatorit Ekonomik: NSH "SPINP AGENCY" të aprovoj si pjesërisht e bazuar.

Komenti i Autoritetit Kontraktues

Si Autoritet Kontraktues kemi proceduar tenderin për "Mirëmbajtja e STN-së" në procedurë të koutimi për shërbime me kriter të dhënies tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët ku kemi pranuar dy (2) oferta në mesin e të cilave edhe ofertën e Operatorit Ekonomik: LOGISTICS PLUS LLC", me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në vlerë 5.880.00 euro i cili është rekomanduar dhe shpallur si fituese e kontratës gjithë rrjedha e procedimit të tenderit konsiderojmë se është proceduar konform dispozitave të LPP-së.

Komisioni i vlerësimit gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, ka vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Komisioni i vlerësimit e ka eliminuar Operatorin Ekonomik: "NSH SPINP AGENCY" për shkak të arsyeve si në vijim:

OE *nuk ka ofrua dëshmi si:*

Për Inxhinierin e Shkencave kompjuterike ,nuk ka ofruar dëshmi që ka përvojë punë profesionale 3 vite pas diplomimit si dhe dëshminë dokumentare kopja e diplomës dhe dëshmia me CV ashtu siç është kërkuar ne njoftimi për kontrate dhe dosje te tenderit. Përgjigja e AK- ne përgjigjen e ekspertit te shqyrtuese me NR1

Nuk pajtohemi me mendimin ekspertit që OE ankues pasi që për personin e Shkencave kompjuterike qe konsiderohet si Inxhinier OE ankuese nuk i ka ofruar dëshmitë siç janë kërkuar ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit pra OE nuk ka ofruar dëshmi qe ka përvojën e punës ne fushe veprimin e profesionit pra tri vite përvojë pune profesionale me lëmin e profesionit dhe është e papranueshme edhe mendimi i ekspertit qe konsideron përvojë pune profesionale i cili nuk mund te llogaritet person profesional pa diplomin, po ashtu kemi dëshmi edhe vendime te Gjykatës Themelore ku citoj: "Përvoja e punës në profesion duhet të llogaritet pas datës se diplomimit" dhe jo si në rastin konkret qe Eksperti shqyrtues dhe OE ka llogaritur përvojën e punës për këtë person edhe para diplomimit, pra person me aftësi profesionale nuk mund te llogaritet personi para diplomimit sepse ai vetëm pas diplomimit mund te quhet profesionist dhe me përvoje punë dhe profesion, prandaj komisioni i vlerësimit e ka konsideruar OE si te papërgjegjshëm, pikërisht për këtë arsye pra OE nuk ka sjellë dëshmi që personi i cekur ne ofertën e tij është diplomuar dhe ka përvojën ne fushe veprimin e profesionit pasi që data e diplomimit të tij është 22.11.2018 dhe se nuk përmbush kriterin tre vjeçar pas diplomimit gjë që edhe ekspertit do te duhej ta hidhte si të pabazuar në tërësi ankesën e OE ankuese.

Nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për pikë të cilën e ka konstatuar eksperti si të bazuar, pretendimi e OE ankuese duhet të hidhej poshtë edhe te vetmen pikë te ankimimit, pasi qe vlerësimi dhe ekzaminimi i ofertave është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, UOPP-së dhe akteve tjera nënligjore dhe në respektim të plotë të kritereve dhe kërkesave të specifikuara në njoftim për kontrate dhe dosje të tenderit, në këtë rast OE i shpërblyer me kontratë është i përgjegjshme pasi i ka ofruar te gjitha dokumentet kërkuar sipas LPP nga AK. Konkluzion:

Autoriteti kontraktues vlerëson se mendimi i ekspertit shqyrtues nuk është i drejtë, duke mos vlerësuar kriteret teknike dhe profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë konform projektit të AK-së, dhe nuk pajtohet me mendimin e tij.

Prandaj, mirëpresim vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së për refuzimin e ankesës dhe miratimin e vendimit të AK-MTI-së për dhënie të kontratës "Tenderi i përgjegjshëm Çmimi më i ulët" ku kemi Operatorin Ekonomik: "LOGISTICS PLUS për 5.880.00 €, i cili edhe është rekomanduar dhe shpallur si fituese i kontratës.

Operatori Ekonomik, me datë: 20.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 01.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH "SPINP AGENCY"- Prishtinë se është eliminuar pa të drejtë nga AK me arsyetimin se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën: "Operatori Ekonomik duhet ofroj se paku 1 person si stafi, i cili do të udhëheqë mirëmbajtjen duhet të këtë diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit."
Ndër të tjera në arsyetimi i AK-së për eliminim është thuhet :
"...ju në kuadër të dokumentacionit të dorëzuar përmes platformës së E-Prokurimit nuk keni ofruar inxhinierin e shkencave kompjuterike për përvojë 3 vjeçare pasi inxhinierin e ofruar është diplomuar me date 22.11.2018, ne këtë rast inxhinier nuk munde të quhet pa diplomë dhe përvoja e punës është kërkuar 3 vite ne fushë veprimit te profesionit te inxhinierit ndërsa për sqarime shtese nuk ka pasur nevoje pasi ne listën e stafit te ofruar keni ofruar vetëm personi/inxhinieri i cili ka diplomuar me 22.11.2018 qe nuk plotëson kërkesat ligjore sipas LPP dhe UOPP..."

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në kërkesa të AK-së nuk është kërkuar Inxhinier, e po ashtu çka është me rëndësi në rastin konkret nuk është kërkuar shprehimisht që përvoja 3 vjeçare duhet të jetë pas diplomimit universitar, kërkesa decidive ka qenë: "...diplomë universitare në lëmin e shkencave kompjuterike, se paku përvojë pune 3 vite ne fushë veprimit te profesionit". Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nga CV e ofruar prej OE ankues, shihet se personi në fjalë ka përvojë si "Software Developer" që nga viti 2014. Andaj OE ankues ka dorëzuar dëshmi në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, obligohet AK të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kritereve të cilat i ka përcaktuar vet në dosjen e tenderit në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se edhe neni 56, par. 3 i LPP-së ka përcaktuar që operatorët

ekonomik nuk përjashtohen nga procedura në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Tregtis dhe Industris"

1x1 OE "SPINP Agency"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.